

Data 04/10/2023

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “BLERJE SOBA PER NGROHJE”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

*Gizë 14711100-9*

*Pajisje për ngrohje 39715200-9*

*Pjesë të sobave, furrave, plintave dhe pajisjeve elektroshtëpiake 39722000-9*

**VLERA E FONDIT LIMIT: 1,499,683** (nje milion e katerqind e nentehjete e nente mije e gjashtëqind e tetedhete e tre) **leke pa TVSH**, vënë në dispozicion nga Vendimi i Këshillit Bashkiak nr.144 datë 28.12.2022 "Për miratimin dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Pogradec për vitin 2023" konfirmuar me shkresën me nr.5/1 prot datë 11.01.2023.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **NDËRMARRJA E MIRËMBAJTJES SË INFRASTRUKTURAVE DHE PUNËVE PUBLIKE** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

*a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

*b. Sigurimin e Ofertës sipas Shtojcës 3 ne vleren **29,993.66** (njetzet e nente mije e nenteqind e nentehjete e tre presje gjashtedhete e gjashte) leke.*

*c. Formularin e ofertes sipas shtojces 1.*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

## 2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

### 2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

**2.2.1.** Për të provuar kapacitetet ekonomike dhe financiare, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për tre vitet e fundit (2020, 2021 dhe 2022), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së parashikuar të kontratës.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 3 të LPP, nenit 43 pika 2 germa c të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik: *“Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

*Ky kriter i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, prandaj është kërkuar që vlera e xhiros të jete jo më e vogël se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 43 pika 2c dhe nenin 55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 pika 1 e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” në zbatim të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formes elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.*

---

**2.2.2** Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit (2020, 2021, 2022), të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre. Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 të LPP, nenit 43 pika 4 germa c të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik: Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke i'u referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të*

*ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar nenit 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji.*

**2.2.3** Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022 dhe viti 2023, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të Ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga autoriteti përkatës në të cilin është regjistruar sipas QKB.

**Shënim:** Ky kriter (2.2.3) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 pika 2 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe sipas ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar), ku në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë regjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, në të cilin përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qënë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën e nënshkruar , vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

*Argumentimi:* Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit,që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet et e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit,që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 40, pika 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar.

**2.3.2** Operoret Ekonomike pjesëmarres duhet te paraqesin Deklaratë se merr përsipër me shpenzimet e veta, furnizimin e mallit të kërkuar sipas preventivit, pranë Autoritetit kontraktor, brenda afateve, kërkesave, sasive dhe specifikimeve të përcaktuara, ne magazinën e N.M.I.P.P, Pogradec.

*Argumentimi:* Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar. Ky vetedeklarim kërkohet per ti vertetuar dhe garantuar AK-së produkte funksionale dhe realizimin me sukses të kontratës përse i përket dorëzimit të produkteve objekt prokurimi.

**2.3.3** Referuar [Udhezimit Nr.03, date 12.04.2022](#) "Mbi procesin e administrimit të mostrave të paraqitura nga operatorët ekonomikë", duke gjykuar nese plotesohen kerkesat minimale te percaktuara ne DST per kete procedure dhe se kontraktuesi do te jete i afte teknikisht qe te realizoje levrimin e mallrave sipas specifikimeve dhe cilesise se kerkuar, cdo operator ekonomik pjesëmarres ne kete procedure, duhet te prezantoje prane N.M.I.P.P, Kati II, Bashkia Pogradec, ditën e përcaktuar per hapjen e ofertave nga 1 (Nje) moster te sobes se zjarrit prej gize.

### **Mos paraqitja e mostrave sipas kushteve te mesiperme, perben shkas per skualifikim.**

Mostrat e paraqitura nga ofertuesit duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor.

*Shenim:* Mostrat e administruara do t'i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që, kontrata në fjalë, të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rast se procedura e prokurimit anulohet, mostrat do ti kthehen

ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit.

**Argumentimi:** Ky kriter bazohet në nenin 40 të VKM-së nr. 285 date 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", pika 6 germa a) ku AK dhe në zbatim të Udhëzimit të Agjencisë së Prokurimit Publik [Nr.03, date 12.04.2022](#) "Mbi procesin e administrimit të mostrave të paraqitura nga operatorët ekonomikë", me qëllim që të gjykohet nese plotesohen kerkesat minimale te percaktuara ne DST per kete procedure dhe se kontraktuesi do te jete i afte teknikisht qe te realizoje levrimin e mallrave sipas specifikimeve dhe cilesise se kerkuar.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

Specifikimet teknike jane hartuar ne perputhje me nenin 36,162/2020 te LPP, si dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" e ndryshuar. Mjeti jane kerkuar sipas nevojave efektive per te permbushur nevojat e ndermarrjes ne menyre te plote per realizimin e sherbimeve ne interes te komunitetit.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".***

*Kujdes:Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".*

## **NJESIA E PROKURIMIT**